



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**  
AGJENCIA SHTETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

### **NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE**

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës,(ASHMDF), në kuadër të bashkëpunimit me UNICEF për ngritjen e **një skuadre lëvizëse** që do të mbështesë punën e Njësisë të Mbrojtjes së Fëmijës në bashki dhe Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës në njësitë administrative, do të punësojë:

- **Një psikolog,**
- **Dy punonjës socialë**
- **Një jurist**

#### **Kushtet e Punësimit**

Kandidatët e përzgjedhur do të punësohen me një kontratë 1- vjeçare.

#### **1. Psikolog**

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore :**

1. Ofron mbështetje teknike për NJMF-të, në menaxhimin e rasteve, veçanërisht me vlerësimin psikologjik të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe anëtarëve të tyre të familjes (nëse është e nevojshme);
2. Ndihmon NJMF-të në koordinim me aktorët lokalë dhe anëtarët e Grupit teknik Ndër-sektorial në bashki dhe njësi administrative, për rastet që kanë nevojë për mbështetje psikologjike;
3. Ofron mbështetje për ngritjen e kapaciteteve për NJMF-të, lidhur me teknikat dhe ofrimin e mbështetjes psikologjike për fëmijët dhe familjet;
4. Mbështet ASHMDF në mbajtjen e dokumentacionit të rasteve të raportuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;
5. Mbështet ASHMDF për identifikimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje të bërë publik në media;
6. Bashkëpunon me anëtarët e tjerë të skuadrës së terrenit për të përditësuar bazën e të dhënave të rasteve të menaxhuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, të cilat janë mbështetur dhe asistuar nga NJMF-të.
7. Harton raporte periodike për punën e realizuar
8. Çdo detyrë tjetër që mund të ngarkohet në funksion të mbarëvajtjes së mirë të projektit

#### **Profili dhe Kualifikimi**

- Diplomë në nivel Master në Psikologji;
- Të paktën 3 vjet përvojë në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;
- Aftësi të mira komunikimi dhe bashkëpunimi në grup;

- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, të shkruar dhe të folur

## **2. Punonjës social**

### **Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore**

1. Ofron mbështetje teknike për Punonjësën e Mbrojtjes së Fëmijës lidhur me:
  - a) Organizimin e punës sipas kërkesave dhe përgjegjësi të përcaktuara në Ligjin 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
  - b) Realizimin efektiv të procesit të menaxhimit të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje;
  - c) Mbjajtjen e dosjeve dhe ruajtjen e dokumentacionit sipas legjislacionit në fuqi;
  - d) Koordinimin me aktorët vendore;
  - e) Asistimi dhe pjesëmarrja në mbledhjet e GTN, dhënia e udhëzimeve dhe sugjerimeve në lidhje me rastet në tërësi si dhe rastet emergjente në process menaxhimi nga NJMF apo PMF.
  - f) Menaxhimin e rasteve ndërshtetërore për mbrojtjen e fëmijës
2. Ofron mbështetje për stafin e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në realizimin e detyrave të parashikuara në ligjin 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
3. Mbështet ASHMDF në menaxhimin e rasteve kur ndërhyrja dhe koordinimi ndërshtetëror është i nevojshëm.
4. Lehtëson komunikimin e Agjencisë me Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës.
5. Ofron mbështetje për ngritjen e kapaciteteve për NJMF-të
6. Mbështet ASHMDF në mbajtjen e dokumentacionit të rasteve të raportuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;
7. Mbështet ASHMDF për identifikimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje të bërë publik në media;
8. Bashkëpunon me anëtarët e tjerë të skuadrës së terrenit për të përditësuar bazën e të dhënave të rasteve të menaxhuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, të cilat janë mbështetur dhe asistuar nga NJMF-të.
9. Harton raporte periodike për punën e realizuar
10. Çdo detyrë tjetër që mund të ngarkohet në funksion të mbarëvajtjes së mirë të projektit.

### **Profili dhe Kualifikimi**

- Diplomë në nivel master në Shkenca Sociale;
- Të paktën 3 vjet përvojë në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;
- Aftësi të mira komunikimi dhe bashkëpunimi në grup;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, të shkruar dhe të folur
- Leje Drejtimi të automjetit, kategoria B

### 3. Jurist

#### Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

1. Mbështet ASHMDf në përgatitjen e raporteve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare (raportime në kuadër të integritimit Europian, Përgatitja e raportimeve për përafrimin e legjislacionit etj);
2. Ndihej NJMF- të në koordinim me aktorët lokalë dhe anëtarët e Grupit teknik Ndërsektorial në bashki dhe njësi administrative;
3. Mbështet NJMF- të në kryerjen e aktiviteteve lokale të ndërgjegjësimit;
4. Ndihej në rritjen e kapaciteteve të NJMF/PMF duke u fokusuar në çështjet ligjore;
5. Mbështet ASHMDf në mbajtjen e dokumentacionit të rasteve të raportuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje duke u kujdesur për përputhjen me kuadrin ligjor në fuqi;
6. Bashkëpunon me anëtarët e tjerë të skuadrës së terrenit për të përditësuar bazën e të dhënave të rasteve të menaxhuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, të cilët janë mbështetur dhe asistuar nga NJMF-të;
7. Harton raporte periodike për punën e realizuar
8. Çdo detyrë tjetër që mund të ngarkohet në funksion të mbarëvajtjes së mirë të projektit.

#### Profili dhe Kualifikimi

- Diplomë në nivel Master në drejtësi
- Të paktën 3 vjet përvojë pune si jurist
- Aftësi të mira komunikimi dhe bashkëpunimi në grup;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, të shkruar dhe të folur
- Leje Drejtimi të automjetit, kategoria B

**Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 14.06.2019 pranë njësisë së burimeve njerzore të institucionit dokumentat si më poshtë vijon:**

- a) Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor) dhe listës së notave;
- b) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- c) Curriculum vitae
- d) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e) Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- f) Fotokopje të Lejes së Drejtimit të automjetit
- g) Çdo document tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsim shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në CV Tuaj;

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dërguar si dhe pikët e marra gjatë intervistës.

**Intervista me gojë do të zhvillohet në datë 19 qershor, pranë Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Adresa: Rruga e Durrësit, nr 83, Tiranë**